



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI**

**Procesverbal**

**Konsultim publik :**

**Data :** 08/05/2026 **Ora :** 12:00

**Vendi:** Salla e Këshillit Bashkiak Pogradec

**Numri i pjesëmarrësve :** Gjithësej 17 persona të pranishëm

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2027-2029 TË BASHKISË POGRADEC ( FAZA1).**

**Pjesëmarrës :**

**Vjollca Pllaha ( Këshilltare )**

**Mimoza Shuli (Këshilltare )**

**Ëngjëll Shyti (Këshilltar)**

**Irsa Karapanca( Drejtore, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar)**

**Alma Kanina: ZV/Kryetare e Bashkisw**

**Qëllimi i takimit**

Zhvillimi i konsultimit publik me banorët lidhur me projekt-vendimin e programit buxhetor afatmesëm 2027-2029, me qëllim për të marrë sygjërimet dhe mendimet e tyre dhe të pasqyrohen ne projekt-buxhet ose në buxhetin e vitit 2027.

**Zhvillimi i mbledhjes**

**I.Karapanca:** Projekt Buxheti Afatmesëm është për periudhën 2027-2029. Vitin 2025 e mbyllëm me sukses. Për të bërë një draft të projekt- buxhetit afatmesëm për vitet 2027-2029 ne kërkojmë mendimet tuaja që ti marrim në konsideratë.

**P.Gjoka:**Unë doja të thoja për rrugën e Nicës dhe Shën Marenës.

**A.Kanina:** Nese e keni dëgjuar Kryetarin kur miratuam buxhetin e vitit 2026 e ka theksuar që këtë vit kemi prioritet këto dy rrugë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

**L.Leka:** Rruga Shemshi Koroveshi ka mbetur në gjysëm dhe duhet përfunduar, gjithashtu rruga e terminalit është e mbingarkuar.

**A.Kanina:** Përsa I përket rrugës Shemshi Koroveshi është një Këshilltare që e ngre gjithmonë si shqetësim.

**V. Pllaha:** Rruga e Osnatit gjithashtu është problem.

**Z.Hamolli:** Një kend lojrash për fëmijë duhet me patjetër në qytet. Parkimi I makinave shumë problem. Pastrimi I Lumit deri te gurorja.

**M.Shuli:** Duhet bërë një studim I visibilitetit që të shohim ku është mundësia për të bërë kënde lojrash.

**A.Kariqi:** Tju jepet urdhër pallateve që të rregullojnë ulluqet e pallateve. Makina e mbeturinave nuk I pastrojnë plotësisht mbeturinat, gjysmat I lenë përsëri në rrugë. Spërkatja e rrugëve gjithashtu le për të dëshiruar.

**R.Pura:** Ura e Selcës-Vëri , Kanali vaditës në fshatin Selcë dhe në fshatin Krickovë.

**F. Gora:** Në fshatin Guras një lagje ka problem me ujerat e zeza. Rruga në hyrje të fshatit Bucimas e dëmtuar, shtrati I lumit le për të dëshiruar. Rruga e fshatit Vërdovë, nga shkolla deri tek varrezat duhet sistemuar.

**M.Shuli:** Gjimnazi “Gjergj Pekmezi” duhet të pajiset me palestër.

**Arben Molla:** Lagjia 4, Rruga e Kalasë duhet të sistemohet duke filluar nga kazanet.

SEKRETARE E KËSHILLIT

Jona BOJKO

